



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.25/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 7 qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.06.2026, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.25/2026, e datës 04.06.2026, parashtruar nga Institutit Demokratik i Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 7 qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 04.06.2026 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 4 qershor 2026, monitoruesit e organizatës sonë kanë hasur vendosje të posterëve në hapësira publike në kundërshtim me ligjin zgjedhor. Konkretisht, monitoruesit tanë kanë vërejtur se janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që flasin për kodin e mirësjelljes së subjekteve politike. Monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se në rrugën: "Eqrem Çabej", në pritoret e stacionit të autobusëve të ndërmarrjes publike të trafikut Urban është hasur vendosja e një posteri me fotografinë dhe emrin e kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës z. Armend Zemaj. Prandaj, bazuar në këto veprime konsiderojmë që është cenuar neni 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2: ku thuhet që: Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim "vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga

organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.”

Andaj, konsiderojmë që nga fotografia e shfaqur, janë konsumuar të gjitha elementet e shkeljes së nenit 34 par. 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe vlerësojmë se PZAP një veprim të tillë kundërligjor nuk do duhej të toleronte. Andaj, kërkojmë nga PZAP ta pranoj këtë ankesë si të bazuar dhe të shqiptojë sanksionin e duhur me gjobë.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur fotografitë nga vendosja e posterit të kandidatit për deputet nga radhët e LDK-së, Armend Zemaj.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.06.2026, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës theksojnë se pretendimi i paraqitur në ankesë se materiali zgjedhor është vendosur në mënyrë të kundërligjshme në hapësirë publike nuk qëndron dhe nuk mbështetet në gjendjen reale faktike dhe juridike. Nga kontrata e bashkëngjitur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe shoqërisë Selmans Network, rezulton qartë se kësaj kompanie i është dhënë e drejta e menaxhimit, administrimit dhe shfrytëzimit të pritoreve të autobusëve dhe hapësirave reklamuese përkatëse për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, duke filluar nga data 15.08.2025. Për rrjedhojë, në kohën kur janë vendosur materialet zgjedhore, kontrata ka qenë në fuqi dhe ka prodhuar efekte juridike të plota. Në bazë të kësaj të drejte kontraktuale, kompania Selmans Network ka lidhur kontratë të veçantë me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese gjatë fushatës zgjedhore. Prandaj, materialet promovuese të kandidatëve të LDK-së janë vendosur mbi bazën e një autorizimi të ligjshëm që buron nga dy kontrata të vlefshme: (i) kontrata ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Selmans Network, dhe (ii) kontrata ndërmjet Selmans Network dhe LDK-së.

Tutja ka shtuar se, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë se kontrata e Komunës së Prishtinës me Selmans Network është shfuqizuar, pezulluar apo ka pushuar së vlejture. Përkundrazi, dokumentacioni i bashkëngjitur dëshmon se operatori ekonomik gëzon të drejtën kontraktuale për administrimin dhe dhënien në shfrytëzim të hapësirave reklamuese deri në përfundimin e afatit kontraktual. Në këto rrethana, pretendimi për përdorim të paautorizuar të pritoreve është i pabazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik dhe duhet të refuzohet në tërësi.

Duke u bazuar në këtë të drejtë kontraktuale, Lidhja Demokratike e Kosovës ka lidhur kontratë të veçantë me kompaninë SELMANAS për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Kontrata është lidhur para vendosjes së materialeve zgjedhore dhe përcakton qartë të drejtën e LDK-së për të vendosur materiale promovuese dhe zgjedhore në lokacionet e menaxhuar nga SELMANAS. Si rezultat, posteri i kandidatit Armend Zemaj është vendosur në bazë të një raporti të rregullt kontraktual dhe me autorizim të subjektit që ka të drejtën ligjore dhe kontraktuale për menaxhimin e këtyre hapësirave reklamuese. Është me rëndësi të theksohet se nuk janë vendosur materiale zgjedhore në mënyrë të njëanshme apo pa autorizim, por ka vepruar në përputhje të plotë me kontratën e lidhur me operatorin ekonomik që menaxhon këto hapësira në bazë të kontratës së lidhur me Komunën e Prishtinës.

Për më tepër, ankesa nuk ofron asnjë provë që do të dëshmonte se kontrata ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe SELMANAS nuk ka qenë në fuqi, apo se SELMANAS nuk ka pasur të drejtë të japë në shfrytëzim hapësirat reklamuese. Përkundrazi, dokumentacioni i

bashkëngjitur dëshmon qartë bazën juridike mbi të cilën është realizuar vendosja e materialit zgjedhor. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë element i shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pasi përdorimi i hapësirës reklamuese është bërë në bazë të kontratave të vlefshme dhe autorizimeve përkatëse. Në bazë të të lartcekurave, kërkojmë nga PZAP që të marrë vendim meritor për rastin në fjalë dhe që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Si provë në përgjigje në ankesë e kanë bashkëngjitur: Kontrata ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe kompanisë SELMANAS, kontratën ndërmjet Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kompanisë SELMANAS për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe pëlqimin nga Komuna e Prishtinës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësues - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, të Instituti Demokratik i Kosovës-KDI dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Instituti Demokratik i Kosovës- KDI, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkëngjitura në përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK kane vërtetuar faktin se me date 28.05.2026 kane lidhur kontratën mes subjektit politik LDK dhe Kompanisë “Selmans Network” për shfrytëzimin e hapësirave – pritoret e autobusëve në Prishtinë me mundësi reklamuese për subjektin politik LDK në periudhën prej 28.05.2026 e deri me 08.06.2026 , kjo kompani ka lidhur dhe Kontratë Për Marrjen në Menaxhim, Modernizim dhe Mirëmbajtjen e Pritoreve të Autobusëve në Prishtinë, me Komunën e Prishtinës, 14-370/03-/22693/25, e datës 15.08.2025, lëshuar për “Selmans Network”. Gjithashtu, me datë 29.05.2026 kompania “Selmans Network” kane marrë Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës për shfrytëzimin e hapësirës publike, shfrytëzimin e pritoreve të autobusëve për reklama të fushatës të zgjedhjeve nacionale, në kuadër të fushatës të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Pra, vendosja e tyre- posterëve është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandëve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara

në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.25/2026 më datë 06.06.2026

Kryesues i Panelit

Ramush Bardhiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.